

VENDIM
Nr. 266, datë 9.5.2025

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK
BASHKIA BELSH, TË PRONËS ME EMËRTIMIN “AGJENCIA SEFERAN,
ELBASAN”, ME NUMËR PASURIE 116/1, NË ZONËN KADASTRALE 3272, DHE PËR
NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 886, DATË 3.11.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 413, DATË 11.7.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Belsh, të pronës me emërtimin “Agjencia Seferan, Elbasan”, në zonën kadastrale 3272, sipas formularit dhe plan-rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për ta përdorur në funksion të projektit “Zhvillimi i turizmit në liqenin Marinëz, turizmit në zonën turistike Seferan dhe rehabilitimi i shtigjeve turistike që lidh liqenet e Rrahmanit-Marinzës”.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 886, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Belsh, të qarkut të Elbasanit”, të ndryshuar.

3. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi i hiqet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 413, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit)”, të ndryshuar.

4. Bashkisë Belsh i ndalohet ndryshimi i destinacionit dhe tjetërsimi i pronës së përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Belsh dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

FORMULARI I PËRDITËSIMIT

Institucioni Qendror Shtetëror: **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT**

Identifikoi: Arjanit **LILOLLARI** - Drejtor Rajonal
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Vili **VREONI** - Drejtor i Drejtorisë Teknike, Standarteve dhe Cilësisë
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Robert **HYSENLLARI** - Drejtor i Përgjithshëm
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)



Nr.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m²)	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret pronë/pasuri	Institucioni me përgjegjësi administrative/ pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë	Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhëna të tjera (Shenime të veçanta)
						Truall (m²)	Ndertesha (m²)						
1	Z.K 3272 K-34-112-(45 B)	116/1	Truall	Ajencia Seferan, Elbasan	10 300	10 300		magazinim	DPRMSH	DRRMSH Tiranë		VKM 274 datë 2.5.2019	1-Sipërfaqe funksionale. Brenda objektit kane qene Depo me hark nr.2, 3, 4, 5, 6 dhe Zyrë+Vend roje.
				Depo me hark 1			374,47						
													2- Katër ndërtime informale të ndërtuara nga Bashkia Belsh në bashkëpunim me FSHZH (të dhënat sipas plan rilevimit)
TOTAL					10 300	10 300	374,47						

PLANRILEVIM
 i Pronës "Agjencia Seferan" Belsh Elbasan

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM(DRRMSH) DATË 06/05/2025 QËLLIMI Përditësim/Transferim

VENDNDODHJA
 Bashkia Belsh ZVASHK Elbasan Nr.Pasurisë 116/1 ZK 3272 Indeksi i Hartës K-34-112-(45-B)

TE DHËNAT E PASURISË
 Lloji i pasurisë TRUALL Sip e pasurisë 10300m² Sip e gjurmës së ndërtimit 374.47 m² Nr. kateve _____ Nr. pemeve _____

N = 4535127.4966
 E = 490317.5953

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

N = 4535127.4966
 E = 490754.5779